

**Zëvendësimi i Derivativëve dhe
Vazhdimi i kontabilitetit mbrojtës**

(Ndryshime në SNK 39)

Ndryshimet në SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe matja

Paragrafët 91 dhe 101 janë ndryshuar. Teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është hequr viza mes përmes.

Mbrojtjet me vlerën e drejtë

...

91 Një njësi ekonomike do të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 89 nëse:

(a) instrumenti mbrojtës ka skaduar ose është shitur, nuk merren më përfitime ose është ushtruar. ~~Është~~ Për këtë qëllim, zëvendësimi apo përtëritja e një instrumenti mbrojtës në një instrument tjetër nuk konsiderohet skadim apo ndërprerje e afatit nëse ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar e njësisë ekonomike. ~~Përveç kësaj, për këtë qëllim nuk ka skadim apo ndërprerje të afatit të instrumentit mbrojtës, nëse:~~

(i) si pasojë e ligjeve apo rregulloreve apo futjes së ligjeve ose rregulloreve, palët e instrumentit mbrojtës janë dakord që një ose më shumë prej palëve të tjera të kleringut të zëvendësojnë palën tjetër fillestare të tyre për t'u bërë palë tjetër e re në secilën prej palëve. Për këtë qëllim, një palë tjetër kleringu është pala tjetër kryesore (e quajtur nganjëherë një "organizatë kleringu 'ose' agjenci kleringu") ose një njësi ekonomike apo disa njësi ekonomike, për shembull, një anëtar i një organizate kleringu ose një klient i një anëtari kleringu të një organizate kleringu, të cilat veprojnë si palë të tjera në mënyrë që të kryhet kleringu nga një palë kryesore tjetër. Megjithatë, kur palët e instrumentit mbrojtës zëvendësojnë palët e tjera fillestare të tyre me palë të tjera të ndryshme ky paragraf do të zbatohet vetëm në qoftë se secila prej këtyre palëve bëjnë kleringun me të njëjtën palë kryesore tjetër.

(ii) ndryshime të tjera, nëse ka ndonjë, në instrumentin mbrojtës kufizohen në ato që janë të nevojshme për bërë një zëvendësim të tillë të palës tjetër. Ndryshimet e tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që priten nëse instrumenti mbrojtës është likuiduar fillimisht me palën tjetër të kleringut. Këto ndryshime përfshijnë ndryshimet në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar tepricat e shumave të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe taksat e ngarkuara.

(b) ...

...

Mbrojtjet e fluksit monetar

...

101 Në secilën nga rrethanat e mëposhtme, një njësi ekonomike do të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafet 95–100:

(a) Instrumenti mbrojtës ka skaduar ose është shitur, nuk merren më përfitime ose është ushtruar (për këtë qëllim, zëvendësimi apo përtëritja e një instrumenti mbrojtës në një instrument tjetër mbrojtës nuk konsiderohet skadim apo ndërprerje e afatit nëse ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë të mbrojtjes, e dokumentuar, e njësisë ekonomike). Në këtë rast, fitimi ose humbja neto kumulative nga instrumenti mbrojtës, që është njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95 (a)), do të mbeten veçmas në kapitalin neto deri sa të ndodhë transaksioni parashikues. Kur transaksioni ndodh zbatohen paragrafet 97, 98 ose 100. Për qëllim të këtij nënparagrafi, zëvendësimi ose përtëritja e një instrumenti mbrojtës me një instrument tjetër mbrojtës nuk konsiderohet skadim apo mbarim afati në qoftë se ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar e njësisë ekonomike. Përveç kësaj, për qëllime të këtij nënparagrafi nuk ka skadim apo ndërprerje të afatit të instrumentit mbrojtës, nëse:

(i) si pasojë e ligjeve apo rregulloreve apo futjes së ligjeve ose rregulloreve, palët e instrumentit mbrojtës janë dakord që një ose më shumë prej palëve të tjera të kleringut të zëvendësojnë palën tjetër fillestare të tyre për t'u bërë palë tjetër e re në secilën prej palëve. Për këtë qëllim, një palë tjetër kleringu është pala tjetër kryesore (e quajtur nganjëherë një "organizatë kleringu 'ose' agjenci kleringu") ose një njësi ekonomike apo disa njësi ekonomike, për shembull, një anëtar i një organizate kleringu ose një klient i një anëtari kleringu të një organizate kleringu, të cilat veprojnë si palë të tjera në mënyrë që të kryhet kleringu nga një palë kryesore tjetër. Megjithatë, kur palët e instrumentit mbrojtës zëvendësojnë palët e tjera fillestare të tyre me palë të tjera të ndryshme ky paragraf do të zbatohet vetëm në qoftë se secila prej këtyre palëve bëjnë kleringun me të njëjtën palë kryesore tjetër.

(ii) ndryshime të tjera, nëse ka ndonjë, në instrumentin mbrojtës kufizohen në ato që janë të nevojshme për bërë një zëvendësim të tillë të palës tjetër. Ndryshimet e tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që priten nëse instrumenti mbrojtës është likuiduar fillimisht me palën tjetër të kleringut. Këto ndryshime përfshijnë ndryshimet në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar tepricat e shumave të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe taksat e ngarkuara.

(b) ...

Paragrafi 108D është shtuar, ndërsa në shtojcën A është shtuar paragrafi UZ113A.
--

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

108D *Zëvendësimi i derivativëve dhe vazhdimi i kontabilitetit mbrojtës* (Ndryshimet në SNK 39), publikuar në qershor 2013, ka ndryshuar paragrafët 91 dhe 101 dhe ka shtuar paragrafin UZ113A. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këta paragrafë për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2014 e në vijim. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2014, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

...

Vlerësimi i efektivitetit të mbrojtjes

...

AG113A Për të shmangur çfarëdo dyshimi, efektet e zëvendësimit të palës tjetër fillestare me një palë tjetër kleringu dhe duke bërë ndryshimet shoqëruese, siç përshkruhet në paragrafët 91 (a) (ii) dhe 101 (a) (ii), do të pasqyrohen në matjen e instrumentit mbrojtës dhe për këtë arsye në vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes dhe matjen e efektivitetit të mbrojtjes.